



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: “W.Center” sh.p.k

Adresa: Fier, Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2 katësh, Përballë” Gjimnazit Perikli Ikonimi”, Fier.

* * *

Procedura e prokurimit: “Blerje Karbon Aktiv për UKT sh.a

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-53188-03-06-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Karbon Aktiv për UKT sh.a” me fond limit 41,387,500 (dyzetë e një milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh
Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët X)

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Atlantik 3 K22218003V

Çmim për njësi 0(zero)

2. Power Industries L51706022H

Çmim për njësi 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

3. W.Center sh.p.k K63029402A

Çmim për njësi 235 (dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh

* * *

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. Atlantik 3 K22218003V

Çmim për njësi 0(zero)

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**Atlantik 3**” nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**Atlantik 3**” s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

2. Power Industries L51706022H

Çmim për njësi 168(njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Power Industries sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar KVO më datë 14.04.2020, nr. prot 5995/9 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik Poëer Industries sh.p.k me qëllim depozitim të dokumentacionit provues dhe argumentimin e ofertës anomalisht të ulët brenda 3 ditëve punë.

Operatori ekonomik nuk paraqiti me shkrim brenda 3 ditëve punë, pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a argumentimin e çmimit të ofertës të dhënë shoqëruar me dokumentacionin provues.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të depozitonte dokumentacion provues pranë AK dhe të argumentonte ofertën anomalisht të ulët në përputhje me nënin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.W.Center sh.p.k

K63029402A

Çmim për njësi 235(dyqind e tridhjetë e pesë)lekë pa tvsh

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë UKT sh.a pranë Drejtorisë së Prokurimeve brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.04.2020

Ankesa: JO